



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Infrastrukturës
Ministarstvo za Infrastrukturu
Ministry of Infrastructure

Ministri i Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 93(4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim Nenin 6.1 të Ligjit nr. 03/L-051 për aviacionin civil, nenin 38 paragrafin 6 të Rregullores nr. 09/2011 të punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, nenit 8 paragrafi 1.4 të Rregullores nr. 02/2011 mbi fushat e përgjegjësiive administrative të zyrës së Kryeministrit dhe ministrave dhe Marrëveshjen shumëpalëshe për themelimin e hapësirës së përbashkët evropiane të aviacionit,

Nxjerr:

RREGULLOREN Nr. 02/2013
MBI TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE PERSONAVE
ME LËVIZSHMËRI TË ZVOGËLUAR GJATË UDHËTIMIT NËPËRMJET AJRIT

Neni 1

1. Rregullorja (KE) nr. 1107/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 korrikut 2006 mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të zvogëluar gjatë udhëtimit nëpërmjet ajrit, në tekstin e mëtejme Rregullorja (KE) nr. 1107/2006, shpallet në tërësinë e saj e aplikueshme në Republikën e Kosovës. Rregullorja (KE) nr. 1107/2006 i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje.
2. Dispozitat në fuqi të Rregullores (KE) nr. 1107/2006 në Republikën e Kosovës janë nenet 1 deri 16 dhe Aneksi I dhe II.
3. Çdo dispozitë që amendanton Rregulloren (KE) nr. 1107/2006, e përcaktuar në në Aneksin I të Marrëveshjes Marrëveshjen shumëpalëshe për themelimin e hapësirës së përbashkët evropiane të aviacionit, (HPEA), do të jetë e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 2

1. Përkufizimi i termeve dhe shprehjeve të përdorura në Nenin 2 të Rregullores (KE) nr. 1107/2006 vlej në këtë rregullore.
2. Pavarësisht paragrafit.1, termet “Komunitet”, “e drejta e Komunitetit”, “legjislacioni i Komunitetit”, “instrumentet e Komunitetit”, “Traktati i KE-së”, “aeroporti i Komunitetit”, “Gazeta Zyrtare e Komunitetit Evropian”, “Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian”, “transportues ajror i Komunitetit” dhe “Shtetet Anëtare”, , vlej në përputhje me Pikat 2 dhe 3 të Aneksit II të Marrëveshjes HPEA.
3. Për qëllime të kësaj Rregulloreje, “organi i zbatimit” i cekur në Nenin 14 të Rregullores (KE) 1107/2006, përkitazi me Republikën e Kosovës, nënkupton Ministrinë e Infrastrukturës së Republikës së Kosovës.
4. Për qëllime të kësaj Rregulloreje, Dënimet e parapara me Nenin 16 të Rregullores (KE) 1107/2006 janë gjrobat e parapara me Nenin 97.2 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil.

Neni 3

Në rast të dallimeve midis versioneve të Rregullores (KE) 1107/2006 në gjuhën shqipe ose serbe, me versionin origjinal të gjuhës angleze, do të vlejë versioni në gjuhën angleze, siç është publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Neni 4

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 22 shkurt 2013



RREGULLORJA (KE) No. 1107/2006 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT

e 5 korrikut 2006

për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të zvogëluar, kur udhëtojnë nëpërmjet ajrit

(Tekst me rëndësi për AEE)

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për krijimin e Komunitetit Evropian, dhe në veçanti Nenin 80 (2) të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit,

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian ⁽¹⁾,

Pas konsultimit të Komitetit të rajoneve,

Duke vepruar në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 251 të Marrëveshjes ⁽²⁾,

Duke qenë:

- (1) Tregu i përbashkët i shërbimit ajror nga i cili duhet të përfitojnë të gjithë qytetarët në përgjithësi, del se edhe personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të zvogëluar, të shkaktuar qoftë nga aftësia e kufizuar, mosha apo ndonjë faktor tjetër, duhet t'u ofrohet mundësia e udhëtimit nëpërmjet ajrit, e njëjtë me atë të qytetarëve të tjerë. Personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të zvogëluar, gëzojnë të drejtën e njëjtë si të gjithë qytetarët e tjerë për lëvizje të lirë, liri të zgjedhjes dhe mosdiskriminim. Ajo që vlen për çdo aspekt tjetër të jetës, vlen edhe për udhëtimin nëpërmjet ajrit.
- (2) Personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të zvogëluar duhet të pranohen dhe të mos refuzohen për transport për shkak të paaftësisë së tyre ose mungesës së lëvizshmërisë, përveç rasteve ku për shkaqe sigurie të përcaktuara me ligj, do të parandalohet udhëtimi i tyre. Para se të marrin rezervimet nga personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të zvogëluar, transportuesit ajrorë, agjentët e tyre dhe operatorët e turizmit duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet e duhura për të verifikuar nëse ekziston një arsye që për shkaqe sigurie do të parandalonte udhëtimin nëpërmjet ajrit të personave në fjalë.

⁽¹⁾ GZ C 24, 31.1.2006, fq. 12.

⁽²⁾ Opinion i Parlamentit Evropian i 15 dhjetorit 2005 (ende i papublikuar në Gazetën Zyrtare) dhe Vendimi i Këshillit i 9 qershorit 2006.

(3) Kjo rregullore nuk duhet të ndikojë në të drejtat e tjera të udhëtarëve të përcaktuara me legjislacionin e Komunitetit dhe në veçanti Direktivën e Këshillit 90/314 / KEE të 13 qershorit 1990 mbi paketat e udhëtimit, paketat e pushimeve dhe paketat turistike (3) dhe Rregulloren (KE) nr. 261/2004 e Parlamentit dhe e Këshillit të 11 shkurtit 2004 që përcakton rregullat e përbashkëta mbi zhdëmtimin dhe asistencën e udhëtarëve në rastin e mospranimit në bord të aeroplanit dhe anulimit ose vonesës së gjatë të fluturimeve. Nëse një rast i tillë do të sjellte të drejtën e njëjtë të zhdëmtimit apo riudhëtimit sipas njëres prej këtyre akteve legislative, si dhe sipas kësaj rregulloreje, personit të tillë do të duhet t'i lejohet ta ushtrojë këtë të drejtë vetëm një herë, sipas zgjedhjes së tij.

(4) Në mënyrë që personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të zvogëluar t'u jepen mundësitë për udhëtime nëpërmjet ajrit, të njëjta me ato të shtetasve të tjerë, asistenca për plotësimin e nevojave të tyre specifike duhet të sigurohet si në aeroport ashtu edhe në bordin e aeroplanit, duke punësuar personelin e nevojshëm dhe pajisjet e duhura për këtë qëllim. Në interes të përfshirjes sociale, personat e interesuar duhet ta marrin këtë asistencë pa pagesë shtesë.

(5) Asistenca e ofruar në aeroportet që ndodhen në territorin e një shteti anëtar në të cilin zbatohet Traktati, duhet t'ua bëjë të mundur personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të zvogëluar, përveç të tjerash, që të vazhdojnë nga një pikë e caktuar e mbërritjes në një aeroport për në aeroplan dhe nga aeroplani për në një pikë të caktuar të nisjes nga aeroporti, duke përfshirë këtu edhe hipjen dhe zbritjen nga aeroplani. Këto pika duhet të përcaktohen së paku në hyrjet kryesore të ndërtesave të terminaleve, në hapësirat me sportelet e kontrollit, në trena, stacione hekurudhore të lehta, stacione të metrove dhe të autobusëve, në radhët e taksive dhe pikat tjera të pushimit, si dhe në parkingjet e veturave në aeroport. Asistenca duhet të organizohet në mënyrë që të shmanget ndërprerja dhe vonesa, duke siguruar standarde të larta dhe të njëjta për tërë Komunitetin, dhe duke i shfrytëzuar më mirë burimet pavarësisht aeroportit ose transportuesit ajror.

⁽³⁾ GZ L 158, 23.6.1990, fq.

59. ⁽⁴⁾ GZ L 46, 17.2.2004, fq. 1.

- (6) Për të arritur këto qëllime, sigurimi i asistencës së cilësisë së lartë në aeroporte duhet të jetë përgjegjësi e një organi qendror. Duke qenë se organet drejtuese të aeroporteve luajnë rolin kryesor në ofrimin e shërbimeve në të gjitha aeroportet e tyre, atyre duhet t'u jepet kjo përgjegjësi e përgjithshme.
- (7) Organet drejtuese të aeroporteve janë ato që mund t'u ofrojnë asistencë personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të zvogëluar. Në anën tjetër, këto organe mund të lidhin kontratë me palët e treta për financimin e kësaj asistence, duke pasur parasysh rolin pozitiv të luajtur në të kaluarën nga operatorët e caktuar dhe transportuesit ajrorë, dhe pa vënë në pikëpyetje zbatimin e rregullave përkatëse të së drejtës komunitare, duke përfshirë këtu edhe ato për prokurimin publik.
- (8) Asistenca duhet të financohet në mënyrë të tillë që barra të shpërndahet në mënyrë të barabartë midis të gjithë udhëtarëve që përdorin një aeroport dhe për të shmangur pengimin e transportit të personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të zvogëluar. Një tarifë e vënë për çdo transportues ajror që përdor një aeroport, në proporcion me numrin e udhëtarëve që ai mbart nga, apo për në aeroport, duket të jetë mënyra më efektive e financimit.
- (9) Tarifat e vëna për një transportues ajror duhet të miratohen dhe zbatohen në transparencë të plotë, për të siguruar në veçanti se janë në përputhje me asistencën e ofruar për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të zvogëluar. Por njëkohësisht edhe për të vërtetuar se këto taksa nuk shërbejnë për të financuar aktivitetet e organit drejtues, me përjashtim të atyre që lidhen me ofrimin e një asistence si kjo. Direktiva e Këshillit 96/67 / KE e datës 15 tetor 1996 për qasje në tregun e shërbimit tokësor në aeroportet e Komunitetit (1) dhe në veçanti dispozitat për ndarjen e llogarive duhet të zbatohen atëherë kur kjo nuk është në kundërshtim me këtë Rregullore.
- (10) Në organizimin e ofrimit të asistencës për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të zvogëluar dhe aftësimin e personelit të tyre, aeroportet dhe transportuesit ajrorë duhet të kenë parasysh dokumentin 30 të Konferencës Evropiane të Aviacionit Civil (KEAC), pjesa I, seksioni 5 dhe shtojcat e bashkangjitura në të, në veçanti Kodin e Sjelljes së Mirë në Shërbimin Tokësor për Personat me Aftësi të Kufizuara Lëvizëse siç përcaktohet në Shtojcën J, në kohën e miratimit të kësaj Rregulloreje.
- (11) Gjatë marrjes së vendimit për projektimin e aeroporteve, terminaleve të reja, dhe rinovimeve më të mëdha, organet drejtuese të aeroporteve duhet të kenë parasysh, kur është e mundur, nevojat e personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të zvogëluar. Në mënyrë të ngjashme duhet të veprojnë edhe transportuesit ajrorë, pra, të marrin parasysh këto nevoja kur vendosin për projektimin e avionëve të rinj dhe të sapo rinovuar, atëherë kur krijohet mundësia për ta bërë një gjë të tillë.
- (12) Direktiva 95/46/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 24 tetor 1995 për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe qarkullimin e lirë të këtyre të dhënave (2) duhet të zbatohet në mënyrë rigorozë me qëllim që të garantojë respektimin e privatësisë së personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të zvogëluar, dhe të sigurojë që informata e kërkuar shërben thjesht për të përmbushur detyrimet e asistencës të përcaktuara në këtë rregullore dhe nuk përdoret kundër udhëtarëve që kërkojnë shërbimin në fjalë.
- (13) Të gjitha informatat e nevojshme që u ofrohen udhëtarëve që udhëtojnë nëpërmjet ajrit duhet të jenë në formate alternative të qasshme për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të zvogëluar, dhe duhet të jenë të paktën në të njëjtën gjuhë si informata e vënë në dispozicion për udhëtarët tjerë.
- (14) Kur karrocet lëvizëse, pajisje të tjera lëvizëse apo mjete ndihmëse humbasin ose dëmtohen gjatë përdorimit në aeroport ose gjatë bartjes në bordin e aeroplanit, udhëtarit të cilit i përket pajisja duhet të zhdëmtohet në përputhje me rregullat e ligjit ndërkombëtar, të komunitetit dhe atij kombëtar.
- (15) Shtetet anëtare duhet të caktojnë një organ përkatës për të kryer detyrat për zbatimin e kësaj rregulloreje, dhe të mbikëqyrin atë me qëllim që të arrihet përputhshmëri e plotë me këtë Rregullore. Kjo mbikëqyrje nuk ndikon në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të zvogëluar për të kërkuar zhdëmtim ligjor nga gjykatat sipas ligjit kombëtar.
- (16) Është e rëndësishme që një person me aftësi të kufizuara ose personi me lëvizshmëri të zvogëluar, i cili konsideron se kjo rregullore është shkelur, të jetë në gjendje të sjellë çështjen në vëmendjen e organit drejtues të aeroportit ose në vëmendjen e transportuesit ajror në fjalë, ashtu siç mund të jetë rasti. Nëse personi me aftësi të kufizuara ose personi me lëvizshmëri të zvogëluar nuk ndahet i kënaqur në këtë mënyrë, ajo ose ai duhet të jetë e/i lirë të parashtrojë një ankesë tek organi ose organet tjera të përcaktuara për këtë qëllim nga shteti përkatës anëtar.
- (17) Ankesat lidhur me asistencën e ofruar në një aeroport duhet drejtuar tek organi ose organet e përcaktuara për zbatimin e kësaj rregulloreje nga shteti anëtar ku ndodhet aeroporti. Ankesat lidhur me asistencën e ofruar nga një transportues ajror duhet drejtuar tek organi ose organet e përcaktuara për zbatimin e kësaj rregulloreje nga shteti anëtar që ia ka lëshuar licencën e operimit transportuesit ajror.

(1) GZ L 272, 25.10.1996, fq. 36. Direktiva e ndryshuar me Rregulloren (KE) Nr. 1882/2003 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (OJ L 284, 31.10.2003, fq. 1).

(2) GZ L 281, 23.11.1995, fq. 31. Direktiva e ndryshuar me Rregulloren (KE) Nr. 1882/2003

- (18) Shtetet anëtare duhet të parashikojnë penalitete të zbatueshme për shkeljet e kësaj rregulloreje, dhe të sigurojnë që ato të zbatohen. Penalitetet, të cilat mund të përfshijnë urdhërimin e pagesës së zhdëmtimit për personin në fjalë, duhet të jenë efektive, proporcionale dhe bindëse.
- (19) Duke qenë se objektivat e kësaj rregulloreje, përkatësisht sigurimi i niveleve të larta dhe të barabarta të mbrojtjes dhe asistencës në të gjitha shtetet anëtare dhe të siguruarit se agjentët ekonomikë veprojnë nën kushte të harmonizuara në një treg të përbashkët, por edhe për shkak të shkallës ose efekteve të veprimit, nuk mund të arrihen në shkallë të mjaftueshme nga shtetet anëtare, kjo mund të arrihet më mirë në nivel Komuniteti, me ç' rast Komuniteti mund të miratojë masa në përputhje me parimin e subsidiaritetit siç përcaktohet në nenin 5 të Traktatit. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit të përcaktuar në atë nen, kjo rregullore nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për të arritur këto objektiva.
- (20) Kjo rregullore respekton të drejtat themelore dhe u përmbahet parimeve të njohura në veçanti nga Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian.
- (21) Marrëveshjet për bashkëpunim më të madh mbi përdorimin e aeroportit të Gjibraltarit u miratuan në Londër më 2 dhjetor 1987 nga Mbretëria e Spanjës dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, në një deklaratë të përbashkët nga Ministri e Punëve të Jashtme të të dyja shteteve. Marrëveshjet të tilla ende nuk kanë hyrë në fuqi,
5. Nëse dispozitat e kësaj rregulloreje bien në kundërshtim me ato të Direktivës 96/67/KE, kjo Rregullore do të mbizotërojë.
6. Zbatimi i kësaj rregulloreje në aeroportin e Gjibraltarit është i kuptueshëm pa vënë në pikëpyetje pozicionet përkatëse ligjore të Mbretërisë së Spanjës dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut në lidhje me mosmarrëveshjen mbi sovranitetin në territorin në të cilin ndodhet aeroporti.
7. Zbatimi i kësaj rregulloreje në aeroportin e Gjibraltarit do të pezullohet derisa të hyjnë në fuqi marrëveshjet e përfshira në Deklaratën e Përbashkët të Ministrave të Jashtëm të Mbretërisë së Spanjës dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut të 2 dhjetorit 1987. Qeveritë e Spanjës dhe të Mbretërisë së Bashkuar do ta informojnë Këshillin për datën e hyrjes në fuqi.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

POR ËSHTË MIRATUAR KJO RREGULLORE:

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo rregullore përcakton rregullat për mbrojtjen dhe ofrimin e asistencës për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të zvogëluar që udhëtojnë nëpërmjet ajrit, për t'i mbrojtur kështu nga diskriminimi dhe për t'u siguruar që ata marrin asistencë.

2. Dispozitat e kësaj rregulloreje do të zbatohen për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të zvogëluar, që përdorin ose synojnë të përdorin shërbimet ajrore të udhëtarëve komercialë në nisjen nga, në transit nëpërmjet ose pas mbërritjes në aeroport, kur aeroporti ndodhet në territorin e një shteti anëtar në të cilin zbatohet Traktati.

3. Nenet 3, 4 dhe 10 vlejnjë edhe për udhëtarët që nisen nga një aeroport i vendosur në një vend të tretë deri në një aeroport të vendosur në territorin e një shteti anëtar në të cilin zbatohet Traktati, nëse transportuesi operativ është një transportues ajror i komunitetit.

4. Kjo Rregullore nuk do të ndikojë në të drejtat e udhëtarëve të përcaktuara me Direktivën 90/314 / EEC dhe sipas Rregullores (KE) nr. 261/2004.

- (a) "Person me aftësi të kufizuara" apo "person me lëvizshmëri të zvogëluar" nënkupton çdo person lëvizshmëria e të cilit është e zvogëluar për shkak të paaftësisë fizike (ndijore ose lëvizëse, të përhershme apo të përkohshme), paaftësi ose dëmtim të intelektit, apo çdo shkak tjetër i paaftësisë, ose moshja dhe gjendja e të cilit kërkon vëmendjen e duhur dhe përshtatjen e shërbimeve të mundësuar për të gjithë udhëtarët, sipas nevojave specifike të tij;
- (b) "Transportues ajror" nënkupton një sipërmarrje të transportit ajror, me një licencë të vlefshme operimi;
- (c) "Transportues ajror operues" nënkupton një transportues ajror që kryen ose ka si qëllim të kryejë një fluturim sipas një kontrate me një udhëtar ose në emër të një personi tjetër, juridik apo fizik, që ka një kontratë me atë udhëtar;
- (d) "Transportues ajror i Komunitetit" nënkupton një transportues ajror me një licencë të vlefshme operimi të lëshuar nga një shtet anëtar në përputhje me rregulloren e Këshillit (EEC) nr. 2407/92 të datës 23 korrik 1992 për licencimin e transportuesve ajrorë (1);
- (e) "Operator turistik" nënkupton një organizator apo shitës që ofron dhe shet paketa turistike, vetë apo nëpërmjet një përfaqësuesi, me përjashtim të transportuesit ajror, sipas nenit 2 (2) dhe (3) të Direktivës 90/314 / KEE;
- (f) "Organ drejtues i aeroportit" ose "organi drejtues" nënkupton një organ, i cili ka si objektiv të tij sipas legjislacionin kombëtar administrimin dhe udhëheqjen e infrastrukturës së aeroportit, dhe koordinimin dhe kontrollin e aktiviteteve të operatorëve të ndryshëm të pranishëm në një aeroport ose sistem aeroporti;

(1) GZL 240, 24.8.1992, fq. 1.

- (g) "përdorues i aeroportit" nënkupton çdo person fizik ose juridik përgjegjës për transportin e udhëtarëve nëpërmjet ajrit nga ose drejt aeroportit në fjalë;
- (h) "Komiteti i Përdoruesve të Aeroportit" nënkupton një komitet përfaqësuesish të përdoruesve të aeroportit apo të organizatave që i përfaqësojnë;
- (i) "rezervim" nënkupton faktin se udhëtari ka një biletë ose dëshmi tjetër, që tregon se rezervimi është pranuar dhe regjistruar nga transportuesi ajror ose operatori i turizmit;
- (j) "aeroport" nënkupton çdo hapësirë tokësore të përshtatur posaçërisht për uljen, ngritjen dhe manovrat e aeroplanëve, duke përfshirë pajisjet ndihmëse që këto operime mund të përfshijnë për kërkesat e trafikut të aeroplanit dhe shërbime që përfshijnë instalimet e nevojshme për të ndihmuar shërbimet ajrore komerciale;
- (k) "parkim i makinave të aeroportit" nënkupton një parkim brenda kufijve të aeroportit ose nën kontrollin e drejtpërdrejtë të organit drejtues të një aeroporti, i cili është në shërbim të drejtpërdrejtë të udhëtarëve që përdorin atë aeroport;
- (l) "shërbim ajror tregtar i udhëtarëve" nënkupton një shërbim të transportit ajror të udhëtarëve që operohet nga një transportues ajror nëpërmjet një fluturimi të planifikuar ose jo të planifikuar që ofrohet për publikun e gjerë për shqyrtim të vlefshëm, qoftë vetë ose si pjesë e një pakete.

Neni 3

Parandalimi i refuzimit të transportit

Një transportues ajror apo agjenti i tij ose një operator turistik nuk do të refuzojë, për shkak të aftësive të kufizuara ose të lëvizshmërisë së zvogëluar:

- (a) të pranojë një rezervim për një fluturim që nisët nga apo mbërrin në një aeroport në të cilin zbatohet kjo Rregullore;
- (b) të nisë një person me aftësi të kufizuara ose një person me lëvizshmëri të zvogëluar në një aeroport të tillë, me kusht që personi në fjalë ka një biletë të vlefshme dhe një rezervim.

Article 4

Përfshirje, kushte të veçanta dhe informim

1. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 3, një transportues ajror apo agjenti i tij ose një operator udhëtimeve mund të refuzojë, për shkak të aftësive të kufizuara apo lëvizshmërisë së zvogëluar, të pranojë një rezervim për të nisur një person me aftësi të kufizuara apo lëvizshmëri të zvogëluar,

- (a) në mënyrë që të përmbushë kërkesat e zbatueshme të sigurisë të përcaktuara me ligj ndërkombëtar, të komunitetit, apo kombëtar, ose për të përmbushur kërkesat e sigurisë të përcaktuara nga autoriteti që i ka lëshuar transportuesit ajror në fjalë, certifikatën e operimit ajror;

- (b) nëse madhësia e aeroplanit ose dyerve të tij e bën të pamundur fizikisht nisjen ose transportin e atij personi me aftësi të kufizuara ose personit me lëvizshmëri të zvogëluar.

Në rast të refuzimit të pranimit të një rezervimi për shkak të përmendura në pikën (a) ose (b) të nënparagrafit të parë, transportuesi ajror, agjenti i tij apo operatori i udhëtimeve duhet të bëjnë përpjekje të arsyeshme për t'i propozuar një alternativë të pranueshme personit në fjalë.

Personi me aftësi të kufizuara ose personi me lëvizshmëri të zvogëluar të cilit i është mohuar hipja në aeroplan, mbi bazën e aftësisë së tij të kufizuar ose lëvizshmërisë së zvogëluar dhe çdo personi që e shoqëron atë sipas paragrafit 2 të këtij neni do t'i ofrohet e drejta për rimbursim ose arritje në destinacionin përfundimtar kur fluturimi kryhet përmes një drejtimi tjetër nga ai që është planifikuar fillimisht, parashikuar në nenin 8 të Rregullores (KE) Nr. 261/2004. E drejta e mundësinë për një fluturim kthimi ose riudhëtim në drejtim tjetër për të arritur destinacionin e dëshiruar, duhet të jetë e kushtëzuar nga përmbushja e të gjitha kërkesave të sigurisë.

2. Nën të njëjtat kushte të cekura në paragrafin 1, nënparagrafi i parë, pika (a), një transportues ajror apo agjenti i tij ose një operator udhëtimi mund të kërkojë që personi me aftësi të kufizuara ose personi me lëvizshmëri të zvogëluar të shoqërohet nga një person tjetër i cili është i aftë të ofrojë asistencën e kërkuar nga ky person.

3. Një transportues ajror apo agjenti i tij duhet të ofrojë publikisht, në formate të qasshme dhe të paktën, në të njëjtat gjuhë si informacioni i vënë në dispozicion të udhëtarëve të tjerë, rregullat e sigurisë që ai zbaton në transportin e personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të zvogëluar, si dhe çdo kufizim për transportin e tyre ose të pajisjeve lëvizëse për shkak të madhësisë së aeroplanëve. Një operator udhëtimeve duhet t'i bëjë të disponueshme rregullat dhe kufizimet e sigurisë për fluturimet, të përfshira në paketat e udhëtimeve, paketat e pushimeve dhe paketat e turneve të cilat organizon, shet ose ofron për shitje.

4. Kur një transportues ajror, agjenti i tij apo operatori i udhëtimeve bën një përjashtim sipas paragrafëve 1 ose 2, duhet të informojë menjëherë personin me aftësi të kufizuara ose personin me lëvizshmëri të zvogëluar për arsyet e këtij përjashtimi. Në bazë të kërkesës, një transportues ajror, agjenti i tij, apo një operator i udhëtimeve duhet t'i komunikojë këto arsye me shkrim personit me aftësi të kufizuara apo personit me lëvizshmëri të zvogëluar, brenda pesë (5) ditëve (pune) nga paraqitja e kërkesës.

Neni 5

Caktimi i pikave të mbërritjes dhe nisjes

1. Në bashkëpunim me përdoruesit e aeroportit, nëpërmjet Komitetit të Përdoruesve të Aeroportit, aty ku ekziston një i tillë, dhe organizatave përkatëse që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të zvogëluar, organi drejtues i një aeroporti, duke marrë parasysh kushtet lokale, duhet të caktojë pikat e mbërritjes dhe të nisjes brenda kufirit të aeroportit, apo në një pikë që është nën kontrollin e drejtpërdrejtë të tij, si brenda ashtu dhe jashtë objekteve të terminalit, në të cilat personat me aftësi të kufizuara ose personat me lëvizshmëri të zvogëluar mund të njohtojnë me lehtësi për mbërritjen e tyre në aeroport dhe të kërkojnë asistencë.

2. Pikat e mbërritjes dhe të nisjes sipas paragrafit 1, do të nënshkruhen qartë dhe do të ofrojnë informata të nevojshme për aeroportin në formate të qasshme.

Neni 6

Përcjellja e informatës

1. Transportuesit ajrorë, agjentët e tyre dhe operatorët e udhëtimeve duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për marrjen e njohtimeve për nevojën për asistencë, të bëra nga personat me aftësi të kufizuara apo lëvizshmëri të zvogëluar, në të gjitha pikat e tyre të shitjes në territorin e shteteve anëtare ku zbatohet Traktati, duke përfshirë dhe shitjet nëpërmjet telefonit dhe internetit.
2. Kur një transportues ajror apo agjenti i tij ose një operator i udhëtimeve marrin një njohtim për nevojën për asistencë së paku 48 orë përpara kohës së nisjes së publikuar për fluturim, ai duhet të përcjellë informatën në fjalë së paku 36 orë përpara kohës së nisjes së publikuar për fluturim:
 - (a) tek organet drejtuese të aeroporteve të nisjes, mbërritjes dhe transitit, dhe
 - (b) te transportuesi ajror operues, nëse rezervimi nuk është bërë me atë transportues, me përjashtim të rastit kur identiteti i transportuesit ajror operues nuk dihet në kohën e njohtimit, rast në të cilin informata duhet të përcillet sa më shpejtë që të jetë e mundur.
3. Në të gjitha rastet, përveç atyre të përmendura në paragrafin 2, transportuesi ajror, apo agjenti i tij ose operatori i udhëtimeve duhet të përcjellin informatën sa më shpejtë që të jetë e mundur.
4. Një transportues ajror operues njohton sa më shpejtë që të jetë e mundur organin drejtues të aeroportit të destinacionit, nëse ndodhet në territorin e një shteti anëtar ku zbatohet Traktati, për numrin e personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të zvogëluara në atë fluturim, asistencën e kërkuar, dhe natyrën e asaj asistence të specifikuar në Shtojcën I.

Neni 7

E drejta për t'u asistuar në aeroporte

1. Kur një person me aftësi të kufizuara apo lëvizshmëri të zvogëluar mbërrin në një aeroport për të udhëtuar nëpërmjet ajrit, organi drejtues i aeroportit do të jetë përgjegjës për të siguruar ofrimin e asistencës të specifikuar në shtojcën I, në atë mënyrë që personit në fjalë t'i mundësohet fluturimi për të cilin ka bërë një rezervim, me kusht që njohtimi për nevojat e veçanta të tij për një asistencë të tillë, janë bërë te transportuesi ajror, apo agjenti i tij ose operatori i udhëtimeve të paktën 48 orë përpara kohës së publikuar të nisjes së fluturimit. Ky njohtim duhet të mbulojë gjithashtu një fluturim kthimi, nëse të dyja fluturimet edhe i nisjes edhe i kthimit janë kontraktuar me të njëjtin transportues ajror.

2. Kur përdorimi i një qeni të njohur të ndihmës është i nevojshëm, ai do të akomodohet me kusht që njohtimi është bërë te transportuesi ajror apo agjenti i tij ose operatori i udhëtimeve në përputhje me rregullat kombëtare në fuqi që mbulojnë transportimin e qenve ndihmës në bordin e aeroplanëve, kur këto rregulla ekzistojnë.

3. Nëse nuk bëhet asnjë njohtim në përputhje me paragrafin 1, organi drejtues duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar asistencën e specifikuar në shtojcën I në atë mënyrë që personit në fjalë t'i mundësohet fluturimi për të cilin ai ka një rezervim.

4. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen me kusht që:

- (a) personi paraqitet personalisht për check-in:
 - (i) në kohën e përcaktuar paraprakisht dhe me shkrim (duke përfshirë edhe formën elektronike) nga transportuesi ajror apo agjenti i tij ose operatori i udhëtimeve, apo
 - (ii) nëse orari nuk është përcaktuar, jo më vonë se një orë përpara orarit të publikuar për nisje, ose
- (b) personi mbërrin në një pikë brenda kufirit të aeroportit të caktuar në përputhje me nenin 5:
 - (i) në orën e përcaktuar paraprakisht dhe me shkrim (duke përfshirë edhe formën elektronike) nga transportuesi ajror apo agjenti i tij ose operatori i udhëtimeve, apo
 - (ii) nëse orari nuk është përcaktuar, jo më vonë se dy orë përpara orarit të publikuar për nisje.

5. Kur personi me aftësi të kufizuara apo personi me lëvizshmëri të zvogëluar kalon transit në një aeroport në të cilin zbatohet kjo Rregullore, apo transferohet nga një transportues ajror apo një operator i udhëtimeve nga fluturimi për të cilin ka një rezervim, në një fluturim tjetër, organi drejtues do të jetë përgjegjës për sigurimin e ofrimit të asistencës së specifikuar në Shtojcën I, në një mënyrë të tillë që personit t'i mundësohet fluturimi për të cilin ka një rezervim.

6. Me mbërritjen nëpërmjet ajrit të një personi me aftësi të kufizuara apo personi me lëvizshmëri të zvogëluar në një aeroport në të cilin zbatohet kjo Rregullore, organi drejtues i aeroportit është përgjegjës për sigurimin e asistencës së specifikuar në Shtojcën I, në atë mënyrë që personit t'i mundësohet të mbërrijë deri në pikën e tij të nisjes nga aeroporti siç specifikohet në nenin 5.

7. Asistenca e ofruar duhet t'i përshtatet, për aq sa është e mundur, nevojave specifike të udhëtarit të caktuar.

Neni 8

Përgjegjësia për asistencë në aeroporte

1. Organi drejtues i një aeroporti do të jetë përgjegjës për sigurimin e ofrimit të asistencës pa pagesë shtesë për personat me aftësi të kufizuara dhe lëvizshmëri të zvogëluar, ashtu siç specifikohet në Shtojcën I.
2. Organi drejtues mund të ofrojë vetë një ndihmë të tillë. Në formë alternative, në përmbushje të përgjegjësisë të veta, dhe gjithmonë në përputhje me standardet e cilësisë sipas nenin 9 (1), organi drejtues mund të lidhë kontratë me një ose më shumë palë të tjera për ofrimin e asistencës. Në bashkëpunim me përdoruesit e aeroportit, nëpërmjet Komitetit të Përdoruesve të Aeroportit, kur një komitet i tillë ekziston, trupi drejtues mund të lidhë një kontratë ose disa kontrata të tilla me iniciativën e vet ose sipas kërkesës, duke përfshirë edhe nga një transportues ajror, dhe duke marrë në konsideratë shërbimet ekzistuese në aeroportin në fjalë. Në rastin kur një kërkesë e tillë refuzohet, organi drejtues duhet të japë një arsyetim me shkrim.
3. Organi drejtues i një aeroporti mundet, mbi baza jo-diskriminuuese, të kërkojë një tarifë të veçantë për përdoruesit e aeroportit me qëllim të financimit të kësaj asistence.
4. Kjo tarifë specifike duhet të jetë e arsyeshme, në bazë të kostos, transparente dhe e vënë nga organi drejtues i aeroportit në bashkëpunim me përdoruesit e aeroportit, nëpërmjet Komitetit të Përdoruesve të Aeroportit kur ekziston, apo çdo subjekt tjetër i përkatës. Kjo tarifë duhet të ndahet midis përdoruesve të aeroportit në përpjesëtim të drejtë të numrit të përgjithshëm të të gjithë udhëtarëve që secili transporton nga, dhe për në atë aeroport.
5. Organi drejtues i një aeroporti duhet të ndajë llogaritë e aktiviteteve të tij që lidhen me asistencën e ofruar për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të zvogëluar, nga llogaritë e aktiviteteve të tjera të tij, në përputhje me praktikën e tanishme tregtare.
6. Organi drejtues i një aeroporti duhet vërë në dispozicion të përdoruesve të aeroportit, nëpërmjet Komitetit të Përdoruesve të Aeroportit, nëse një i tillë ekziston, apo dhe çdo subjekti tjetër përkatës, si dhe organit zbatues ose organeve të cekura në nenin 14, një pasqyrë vjetore të audituar të tarifave të mbledhura dhe shpenzimeve të bëra për asistencën e ofruar personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të zvogëluar.

Neni 9

Standardet e cilësisë për ndihmë

- 1 Me përjashtim të aeroporteve, trafiku vjetor i të cilave është më pak se njëqind e pesëdhjetë mijë (150 000) lëvizje të udhëtarëve për qëllime komerciale, trupi drejtues duhet të përcaktojë standarde të cilësisë për asistencën e specifikuar në Shtojcën I dhe të përcaktojë kërkesat e burimeve për përmbushjen e tyre, në bashkëpunim me përdoruesit e aeroportit, nëpërmjet Komitetit të Përdoruesve të Aeroportit, nëse ekziston një i tillë, dhe organizatat që përfaqësojnë udhëtarët me aftësi të kufizuara dhe udhëtarët me lëvizshmëri të zvogëluar.

2. Në vendosjen e këtyre standardeve, do të merren në konsideratë të plotë politikat e njohura ndërkombëtare dhe kodet e mirësjelljes në lidhje me lehtësimin e transportit të personave me aftësi të kufizuara ose personave me lëvizshmëri të reduktuar, sidomos Kodi i Sjelljes së Mirë i KEAC-it në Shërbimet Tokësore për Personat me Aftësi të Kufizuara Lëvizëse.
3. Organi drejtues i një aeroporti duhet të publikojë standardet e veta të cilësisë.
4. Një transportues ajror dhe organi drejtues i një aeroporti mund të bien dakord që, për udhëtarët që ai transporton nga, dhe për te ai aeroport, organi drejtues duhet të ofrojë asistencë të standardeve më të larta se sa standardet e cekura në paragrafin 1 ose të ofrojë shërbime shtesë sipas atyre të specifikuara në Shtojcën I.
5. Për qëllim të financimit, organi drejtues mund të mbledhë një tarifë nga transportuesin ajror përveç atyre që janë përcaktuar në nenin 8 (3), e cila duhet të jetë transparente, në varësi të kostos dhe e vënë pas konsultimit të transportuesit ajror në fjalë.

Neni 10

Ndihma nga transportuesit ajrorë

Një transportues ajror duhet të sigurojë asistencën e specifikuar në Shtojcën II pa pagesë shtesë për personin me aftësi të kufizuara apo personin me lëvizshmëri të zvogëluar, nisur nga, mbërritur në ose transit në një aeroport ku kjo Rregullore zbatohet, me kusht që personi në fjalë i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 7 (1), (2) dhe (4).

Neni 11

Trajnimet

Transportuesit ajrorë dhe organet drejtuese të aeroportit duhet:

- (a) të sigurojnë që i gjithë personeli i tyre duke përfshirë edhe ata të punësuar nga nënkontraktorët, që u ofrojnë asistencë të drejtpërdrejtë personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të zvogëluar, kanë njohuri se si t'i përmbushin nevojat e personave që kanë paaftësi të ndryshme ose dëmtime;
- (c) të ofrojnë trajnime për barazi në paaftësi dhe ndërgjegjësimit mbi paaftësinë për të gjithë personelin që punon në aeroport, që ka të bëjë drejtpërdrejt me publikun udhëtuës;
- (d) të sigurojnë që, pas punësimit, të gjithë punonjësit të kryejnë trajnimin në lidhje me paaftësinë dhe që ky personel të bëjë trajnime rifreskuese kur është e nevojshme;

Neni 12

Zhdëmtimi për karrocet lëvizëse të humbura apo të dëmtuara, pajisje të tjera lëvizëse dhe pajisje ndihmëse

Kur karrocet lëvizëse apo pajisje të tjera lëvizëse ose pajisje ndihmëse humbasin ose dëmtohen gjatë shërbimit të udhëtarëve në aeroport apo gjatë bartjes në bordin e aeroplanëve, udhëtarit të cilit i përket pajisja duhet të zhdëmtohet, në përputhje me rregullat e ligjit ndërkombëtar, të komunitetit dhe atij kombëtar.

Article 13

Përfshirja dhe heqja dorë nga detyrimet

Detyrimet kundrejt personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të zvogëluar në pajtim me këtë Rregullore nuk duhet të kufizohen apo të hiqet dorë nga ato.

Neni 14

Organi zbatues dhe detyrat e tij

1. Çdo shtet anëtar do të caktojë një organ apo organe përgjegjëse për zbatimin e kësaj rregulloreje për sa i përket fluturimeve që nisen nga, ose mbërrijnë në aeroportet që ndodhen në territorin e tij. Kur është e përshtatshme, ky organ apo organe duhet të marrin masat e nevojshme për të siguruar respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të reduktuar, duke përfshirë pajtueshmërinë me standardet e cilësisë nga neni 9 (1) i kësaj rregulloreje. Shtetet anëtare do të informojnë komisionin për organin ose organet e përcaktuara.
2. Shtetet anëtare duhet, kur është e nevojshme, të parashikojnë që organi zbatues ose organet e përcaktuara sipas paragrafit 1 do të sigurojnë zbatimin e kënaqshëm të nenit 8, përfshirë edhe dispozitat për paditë me qëllim të shmangies së konkurrencës së padrejtë. Ato gjithashtu mund të caktojnë një organ të posaçëm për këtë qëllim.

Article 15

Procedura e ankesës

1. Një person me aftësi të kufizuara apo person me lëvizshmëri të zvogëluar, i cili konsideron se kjo rregullore është shkelur, mund të sjellë çështjen në vëmendjen e organit drejtues të aeroportit apo në vëmendjen e transportuesit ajor në fjalë, sipas rastit.
2. Nëse personi me aftësi të kufizuara apo personi me lëvizshmëri të zvogëluar nuk ndahet i kënaqur në këtë mënyrë, ankesat mund të bëhen në çdo organ apo organe të përcaktuara sipas nenit 14 (1), ose në çdo organ tjetër përgjegjës të përcaktuar nga një shtet anëtar për shkeljen e pretenduar të kësaj Rregulloreje.

Kjo rregullore do të jetë e detyrueshme në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejtë e zbatueshme në të gjitha shtetet anëtare.

E hartuar në Strasburg, më 5 korrik 2006.

Për Parlamentin Evropian
Kryetari
J. BORRELL FONTELLES

Kryetari
i Këshillit
P. LEHTOMÄKI

3. Një organ i një shteti anëtar i cili merr një ankesë në lidhje me një çështje që rezulton të jetë nën përgjegjësinë e një organi të emëruar të një shteti tjetër anëtar, duhet t'ia delegojë ankesën organit të atij shteti.
4. Shtetet anëtare duhet të marrin masa për të informuar personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të zvogëluar për të drejtat e tyre sipas kësaj Rregulloreje dhe mundësinë e ankesës në organin e caktuar.

Neni 16

Penalitetet

Shtetet anëtare do të përcaktojnë rregullat mbi penalitetet e zbatueshme kundrejt shkeljeve të kësaj rregulloreje dhe do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të garantuar që këto rregulla janë zbatuar. Penalitetet e vendosura duhet të jenë efektive, proporcionale dhe bindëse. Shtetet anëtare do të njoftojnë komisionin lidhur me këto dispozita, dhe pa vonesë për çdo ndryshim të mëvonshëm që do të prekte ato.

Article 17

Raporti

Komisioni do t'i raportojë Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi funksionimin dhe efektet e kësaj rregulloreje, më së voni deri më 1 janar 2010. Raporti duhet të shoqërohet kur është e nevojshme nga propozimet legjislative që zbatohen në hollësi të mëtejshme dispozitat e kësaj rregulloreje, ose e rishikojnë atë.

Article 18

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e 20-të pas publikimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Ajo do të fillojë të zbatohet nga 26 korriku 2008, me përjashtim të neneve 3 dhe 4, me zbatimin e të cilave do të fillohet nga 26 korriku 2007.

SHTOJCA I

Asistenca nën përgjegjësinë e organeve drejtuese të aeroporteve

Asistenca dhe rregullimet e nevojshme për të mundësuar personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të zvogëluar:

- për të lajmëruar mbërritjen e tyre në aeroport dhe kërkesën për asistencë në pikat e caktuara brenda dhe jashtë ndërtesave të terminalit siç janë përcaktuar në nenin 5,
- për të lëvizur nga një pikë e përcaktuar te sporteli i check-in/hyrjes;
- për të bërë check-in dhe për të regjistruar bagazhin;
- për të vazhduar mëtej nga sporteli i check-in/hyrjes drejt aeroplanit, pas përfundimit të procedurave të emigrimit, doganave dhe sigurisë;
- për të hipur në aeroplan, me ndihmën e ashensorëve, karrocave lëvizëse apo asistencës tjetër të nevojshme, sipas rastit;
- për të vazhduar nga dera e aeroplanit deri te vendi përkatës;
- për të vendosur dhe marrë bagazhet në aeroplan;
- për të vazhduar nga vendi përkatës për në derën e aeroplanit;
- për të zbritur nga aeroplani, me ndihmën e ashensorëve, karrocave lëvizëse apo asistencës tjetër të nevojshme, sipas rastit;
- për të vazhduar nga aeroplani për në sallën e bagazheve dhe për t'i tërhequr ato, pas përfundimit të procedurave të emigrimit dhe doganave,
- për të vazhduar nga salla e bagazheve te një pikë e përcaktuar,
- për të gjetur fluturimet lidhëse kur janë në transit, me ndihmën në ajër dhe në tokë dhe brenda dhe ndërmjet terminaleve, sipas nevojës;
- për të lëvizur në hapësirat e tualeteve kur kërkohet.

Kur një person me aftësi të kufizuara apo një person me lëvizshmëri të zvogëluar asistohet nga një shoqëruar, këtij personi, nëse kërkohet, do t'i lejohet të ofrojë asistencën e nevojshme në aeroport, si dhe hipjen dhe zbritjen nga aeroplani të personave në fjalë.

Shërbimi tokësor të të gjitha pajisjeve të nevojshme lëvizëse, duke përfshirë pajisje të tilla si karrocacat lëvizëse elektrike që i nënshtrohen paralajmërimit paraprak prej 48 orësh dhe kufizimeve të mundshme të hapësirës në bordin e aeroplanit, si dhe zbatimit të legjislacionit përkatës në lidhje me mallrat e rrezikshme,

Zëvendësimi i përkohshëm i pajisjeve lëvizëse të dëmtuara ose të humbura, megjithëse jo domosdoshmërisht të ngjashme me ato të mëparshmet.

Shërbimi tokësor i qenve të njohur të ndihmës, kur kjo është e nevojshme.

Komunikimi i informatës së nevojshme për të realizuar fluturimin sipas formateve të qasshme.

SHTOJCA II

Asistenca nga transportuesit ajrorë

Bartja në kabinë e qenve të njohur të ndihmës, në përputhje me rregulloret kombëtare.

Përveç pajisjeve mjekësore, transporti i më së shumti dy pjesëve të pajisjes lëvizëse për çdo person me aftësi të kufizuara apo person me lëvizshmëri të zvogëluar, duke përfshirë karrocën lëvizëse elektrike (që i nënshtrohen një paralajmërimi paraprak prej 48 orësh dhe kufizimeve të mundshme të hapësirës në bordin e aeroplanit, si dhe zbatimit të legjislacionit përkatës në lidhje me mallrat e rrezikshme).

Komunikimi i informatës së nevojshme për të realizuar fluturimin sipas formateve të qasshme.

Bërja e të gjitha përpjekjeve të arsyeshme për të rregulluar që vendi i uljes të jetë i përshtatshëm për nevojat e personave me aftësi të kufizuara dhe lëvizshmëri të zvogëluar, sipas kërkesës, dhe në varësi të kriterëve të sigurisë dhe disponueshmërisë,

Asistenca në lëvizjen në hapësirat e tualeteve, nëse kërkohet.

Kur një person me aftësi të kufizuara apo person me lëvizshmëri të zvogëluar asistohet nga një shoqëruar, transportuesi ajror do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme që t'i japë këtij personi një vend pranë personit me aftësi të kufizuara ose personit me lëvizshmëri të zvogëluar.
